

**CRIMINAL ACTS AS THE BASIS OF CRIMINAL LEGAL RESPONSIBILITY****Jetmire Zeqiri**

University in Tetovo, Tetovo, Macedonia jetmire.zeqiri@unite.edu.mk

**Abstract:** Criminal liability is the most serious type of legal liability, from the point of view of the consequences for the individual. (Compared with legal administrative, civil, disciplinary responsibility). This is one of the reasons, and even the foremost, that this kind of responsibility, both in doctrine, in legislation, and in the practical activity of the prosecution and court bodies in democratic countries. It is well known that criminal liability is nothing other than the obligation of the perpetrator to be subjected to the criminal punishment for the offense committed by him, on the one hand, and the right of the state, that through the fulfillment of a number of legal requirements of the law material and procedural criminal law, to require him to fulfill this obligation, on the other hand. The basis of criminal liability constitutes the presence of a criminal offense. While the prerequisite or prerequisite of it constitutes the determination of the figure of the concrete criminal offense, which is foreseen in the specific provision of the special part of the Criminal Code or of special criminal laws. It is precisely the specific provision of the Special Part of the Criminal Code, which provides for a concrete type of criminal offense on the basis of which the person or suspects will be charged as perpetrators of the offense.

**Keywords:** criminal offense, criminal liability, criminal offense, lawlessness, act or omission, fault, etc.

**1. KUPTIMI, PËRMBAJTJA DHE ELEMENTËT E PËRGJEGJËSISË PENALE**

Me përgjegjësi penale kuptohet zbatimi i kërkesave të cilat lidhen së pari, me procedurën e marrjes në përgjegjësi penale të parashikuar nga legjislacioni procedural penal, së dyti, shqyrtimin dhe hetimin e çështjes gjatë gjykimit, së treti, marrjen e vendimit gjyqësor, së katërti, vuajtjen e dënimit të dhënë nga gjykata, së pesti, kufizimet e tjera të përcaktuara në vendimin e gjykatës ndaj personit të marrë si i pandehur për kryerjen e veprës penale<sup>232</sup>. Përgjegjësia penale, është lloji më i rëndë i përgjegjësive juridike, nga këndvështrimi i pasojave që sjell për individin. (Krahasuar me përgjegjësinë juridike administrative, civile, disiplinore). Kjo, është dhe një nga arësyet, madje kryesorja, që kësaj lloji përgjegjësie, si në doktrine, në legjislacion, edhe në veprimtarinë praktike të organeve të prokurorisë dhe gjykatës në vendet demokratike. Dihet se, përgjegjësia penale nuk është gjë tjetër veç detyrimi i autorit të veprës penale që ti nënshtrohet dënimit penal për veprën penale të kryer prej tij, nga njëra anë, dhe të drejtës së shtetit, që nëpërmjet përbushjes së një sërë kërkesash ligjore të së drejtës material dhe asaj procedurale penale, të kërkojë prej tij që të plotësojë këtë detyrim, nga ana tjetër. Bazën e përgjegjësive penale e përbën prania e veprës penale. Ndërsa kushtin paraprak apo parakushtin e saj, e përbën përcaktimi i figurës së veprës penale konkrete, e cila parashikohet në dispozitën, konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal ose të ligjeve të posaçme penale. Është pikërisht dispozita konkrete e Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, në të cilën parashikohet lloji konkret i figurës së veprës penale në bazë të së cilës do të akuzohet personi, apo personat e dyshuar, si autorë të veprës penale. Kuptimi i përgjithshëm i përgjegjësive në doktrinën e së drejtës ka kuptime të ndryshme. Për shëmbull, përgjegjësi për pasojën e shkaktuar me veprimet e veta, përgjegjësi si detyrim për përbushjen e detyrave të caktuara juridike. Sipas përkufizimeve të dhëna, përgjegjësia, përfaqëson një raport të dyanshëm ndërmjet dy subjekteve. Raport midis atij që përgjigjet dhe atij para të cilit përgjigjet i pari. Askush nuk mund që për veprimet e tij të përgjigjet para vetes së tij, përveç se në formë të përgjegjësive para ndërgjegjes së tij. Vepra penale është kategoria kryesore në sistemin e së drejtës penale. Vepra penale legjitimon të drejtën e ndëshkimit dhe përcakton gjerësinë e represionin penal-juridik, kurse nga nocioni i saj nxirren edhe kategori të tjera themelore, si përgjegjësia penale dhe dënimi. Përgjegjësia penale përcaktohet sipas disa kriterëve shkencore të parashikuar në ligjin material dhe që trajtohen nga doktrina, nga teoria e së drejtës penale. Këto kriterë janë të natyrës juridike dhe faktike. Kriteret juridike kanë të bëjnë kryesisht me disa përcaktime të ligjit, ose të teorisë të së drejtës penale. I tillë është parimi i mosdënimit pa ligj, sipas të cilit askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë që më parë nuk është parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose si kundravajtje penale. Kriteret e natyrës faktike kanë të bëjnë me rrethanat e kryerjes së veprës. Prej tyre, të drejtës penale i interesojnë së pari, ato rrethana që përbëjnë anën objektive të figurës së veprës penale dhe së dyti, rrethanat, të cilat shërbejnë për të arritur në përfundimin nëse ekziston apo jo ana subjektive e figurës së veprës penale, nëse personi ka vepruar me faj, rast pas rasti. Thelbësore në zgjidhjen e problemit të përgjegjësive penale për vepra që parashikohen në ligj si vepra penale, është që personi të ketë mbushur moshën e kërkuar nga ligji, 14 vjeç

<sup>232</sup> I. Elezi., S. Kaçupi., M. Haxhia., “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Tiranë 2009, Fq.87

për krime dhe 16 vjeç për kundravajtjet penale në kohën e kryerjes së tyre, të ketë vepruar me faj dhe të ketë lidhje shkakësore midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave shoqërisht të rrezikëshme. Megjithëse jo i shprehur në ligj, kusht i domosdoshëm është edhe që personi të jetë i përgjegjshëm. Për përgjegjshmërinë, as për sa i përket kuptimit dhe përmbajtjes së saj, as edhe thjesht si nocion, nuk bëhet fjalë, jo vetëm në Kodin Penal, i cili është në fuqi, por as edhe në dy kodet e mëparëshme. Kuptimin e këtij instituti, jo vetëm si nocion thjesht tekniko-juridik, por në rradhë të parë e mbi të gjitha, si nocion shoqëror, me përmbajtje të theksuar të natyrës psikiko-psikologjike, e jep doktrina e së drejtës penale. Një nga kushtet që veprimi apo mosveprimi të jetë shkak për përgjegjësi penale, është që personi, i cili e kryen atë, të ketë atë që në teorinë e së drejtës penale, quhet “ndërgjegja e çënimit”. Me këtë duhet kuptuar që personi të jetë në gjendje të vlerësojë nëse veprimi apo mosveprimi i tij është i dobishëm ose i dëmshëm për shoqërinë, apo për individë të veçantë. Përgjegjësia penale është detyrimi i autorit të veprës penale për t’ju nënshtruar kërkesave ligjore dhe dënimit të caktuar ndaj tij për veprën penale të kryer. Pra, përgjegjësia penale lidhet me përgjegjshmërinë e personit, me aftësinë për të kuptuar dhe kontrolluar sjelljen e tij. Nga ana tjetër, lindja e përgjegjësive penale detyron organet kompetente të fillojnë procedimin penal në përputhje me rregullat e ligjit procedurial, me qëllimin e vetëm për të materializuar këtë përgjegjësi. Përgjegjësia penale është përgjegjësi individuale.

### **1.1 Analizë e shkurtër e kuptimit të veprës penale, dhe elementët përbërës të saj**

Përcaktimi i kuptimit të veprës penale është një ndër detyrat kryesore të legjislacionit penal dhe të shkencës së të drejtës penale. Do të thotë, përcaktimi i nocionit të veprës penale, I përgjegjësive penale dhe i sanksioneve penale përbëjnë tre çështje kryesore të cilat i shqyrton e drejta penale. Në rradhën e ketyre tre çështjeve, vepra penale zë vendin e parë sepse vepra penale shërben si bazë për përgjegjësinë penale. Kur ligjvënësi parashikon një fakt si vepër penale ka si qëllim goditjen e atyre sjelljeve njerëzore të cilat prekin të mira që kanë një vlerë themelore për të gjithë shoqërinë. Bëhet fjalë për të mira juridike, të cilat mund të jenë të drejta personale të individit, por edhe interesa të tij apo të shoqërisë. Pikërisht për të kuptuar vlerën juridike të fakteve të parashikuara nga ligji si vepra penale në lidhje me të mirat juridike të cilat ligjvënësi synon të mbrojë, është e nevojshme ndarja dhe analizimi shkencor i të gjithë elementëve përbërës të veprës penale. Analizimi i veprës penale kalon domosdoshmërisht në ndarjen e saj në disa element që përbëjnë thelbin strukturor. Kjo është e nevojshme jo vetëm pasi lehtëson studimin e saj, por edhe për faktin se përbën një mjet solid për gjykatësin në interpretimin korrekt të ligjit penal. Vetëm me anë të një analize të thellë të elementëve përbërës të veprës penale, gjykatësi mund të jap një gjykim të saktë dhe të drejtë mbi përgjegjësinë penale të një individi. Pra, studimi shkencor i strukturës së veprës penale është i nevojshëm për të verifikuar korrektësinë e vendimeve gjyqësore. Me fjalën strukturë të veprës penale duhet të kuptuar elementët e domosdoshëm në të gjitha veprat penale. Si rrjedhojë analiza e strukturës ka të bëjë me gjetjen e elementëve thelbësor pa të cilën nuk mund të ketë vepër penale. Analiza e veçantë e secilit element të veprës penale është e nevojshme nga ana metodologjike në studimin dhe interpretimin e veprës penale. Por, për të patur vepër penale, është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj. Në teorinë e së drejtës penale janë shfaqur mendime të ndryshme në lidhje me kuptimin e veprës penale. Së pari, vepra penale trajtohet si një fenomen juridik. Por vepra penale konsiderohet edhe si fenomen social. Si veprim apo sjellje e njeriut të caktuar nga e cila dëmtohen apo rrezikohen vlera të caktuara të shoqërisë apo të individit. Në këtë aspekt, kjo sjellje e njeriut, (veprimi apo mosveprimi) e cila është në kundërshtim me interesat e shoqërisë ose të individit, midis të tjerash është një manifestim i personalitetit të tij, është një shprehje e gjëndjes së tij psikike në një moment të caktuar. Vepra penale konsiderohet si fenomen juridik apo fakt juridik, i cili shkakëton pasoja juridike në botën e jashtëme. Pra, me vepër penale në aspektin formal do të kuptojmë atë sjellje njerëzore, e cila me ligj është sanksionuar si vepër penale. Sipas këtij përkufizimi, nuk shqyrtohet se vepra penale është vepër penale kundër moralit dhe shoqërisë, por vetëm nëse ajo është e kundërligjshme. Një përkufizim i tillë nuk parashikon se për cilat shkaqe kjo sjellje konsiderohet vepër penale, por e lidh vetëm me atë që kjo sjellje duhet të jetë e kundërligjshme. Në aspektin material, vepra penale është vepër apo sjellje e njeriut, e cila dëmton apo rrezikon vlerat elementare të njeriut, të shoqërisë dhe sistemit juridik. Bëhet fjalë për vlera jetike nga të cilat varet ekzistenca e individit dhe e shoqërisë. Do të konsiderohet vepër penale ajo sjellje e njeriut që duhet të paraqesë rrezikshmëri shoqërore. Sipas këtij përkufizimi, kjo sjellje e njeriut, pavarësisht se është e kundërligjshme, por që nuk është e rrezikshme për shoqërinë, nuk përbën vepër penale<sup>233</sup>. Përcaktimin e rrezikshmërisë shoqërore ligjvënësi e bën në bazë të kushteve objektive të shoqërisë. Vlerësimi, nëse një veprim apo mosveprim paraqet rrezikshmëri shoqërore, bëhet duke u nisur nga interesat e kësaj shoqërie. Nga këto nocione të veprës penale vihet re se kuptimi formal e shpjegon faktin vetëm në aspektin juridike formal. Kurse,

<sup>233</sup> F. Mantovani, Diritto Penale, parte generale, Padova, 2007, fq.100

nocioni material, jep përgjigje se për çfarë shkaqesh një veprë konsiderohet veprë penale, arësyet se përse ai veprim është i dëmshëm. Të marra në mënyrë të shkëputur, këto dy teori, nuk e përcaktojnë në mënyrë adekuate dhe në tërësi nocionin e veprës penale<sup>234</sup>. Si konkluzion, mund të thuhet se vepra penale përkufizohet vetëm nëse merren parasysh elementët formal dhe material të saj. Përsa i përket doktrinës të së drejtës penale, në dhënien e një përkufizimi të saktë, i është përmbajtur të dy parimeve: të aspektit formal dhe atij material<sup>235</sup>. Sipas këtij nocioni, formal-material, veprë penale është ai veprim ose mosveprim i kundërligjshëm, shoqërisht i rrezikshëm, i cili kryhet me faj. Pra, baza juridike për përcaktimin e veprës penale është rrezikshmëria shoqërore dhe kundërligjshmëria e veprës. Rrezikshmëria shoqërore e veprës përbën tiparin material të veprës, kurse kundërligjshmëria, tiparin formal-juridik të saj. Studimi i veprës penale merr rëndësi se duke përcaktuar se çfarë është veprë penale, e drejta penale hedh bazat për një luftë kundër kriminalitetit. Synohet që të vendosen përpara përgjegjësisë penale vetëm personat që kryejnë vepra penale, vepra të cilat plotësojnë kushtet e përkufizimit që jep doktrina e së drejtës penale. Kjo përbën edhe garancinë themelore të procesit penal. Shihet, pavarësisht diferencave, më së shumti për shkak të mënyrës së formulimeve që bëhen, vepra penale përkufizohet si një veprë (veprim ose mosveprim) shoqërisht e rrezikshme e parashikuar në ligj (e kundërligjshme) dhe e kryer me faj. Nisur nga këto përkufizime, si element të veprës penale, në doktrinë, përcaktohen:

- a) Veprimi ose mosveprimi (vepra);
- b) Rrezikshmëria shoqërore;
- c) Kundërligjshmëria dhe
- d) Faji

### 1.2. Veprimi ose mosveprimi

Vepra penale mund të kryhet si me veprim ashtu edhe me mosveprim. Nëse veprimi do të konsiderohet sjellja aktive e personit, e perceptueshme duke kryer diçka, me mosveprim do të kuptojmë atë qëndrim pasiv të njeriut, duke mos kryer diçka që duhet ta kryente. Nëse veprimi është ajo sjellje aktive, si një lëvizje trupore e vullnetëshme, mosveprimi paraqitet si sjellje pasive e personit në botën e jashtëme. Mosveprimi është një nocion i kundërt i veprimit. Të drejtës penale nuk i intreson cilido qëndrim pasiv i personit, thjesht mos bërja e diçkaje. I intreson qëndrimi pasiv ndaj diçkaje që personi duhet të kryente sipas ligjit apo sipas detyrës së tij. Për shëmbull, “Mosdhënia e ndihmës, pa shkaqe të arsyeshme nga ana e personit që me ligj ose për shkak të detyrës detyrohej ta jepte atë,.....”ose “Mosdhënia e mjeteve të nevojshme për jetesën e fëmijëve, të prindërve ose të bashkëshortit, nga personi që në zbatim të një vendimi gjyqësor detyrohet ta japë,.....”përbëjnë kundërvajtje penale. Si veprimi ashtu edhe mosveprimi, kur përmbushin kushtet e mësipërme kanë rëndësi për të drejtën penale. Megjithatë shkalla e rrezikshmërisë e veprave penale të kryera me veprim, si rregull është më e madhe se ajo e veprave penale të kryera me mosveprim. Mosveprimi përcaktohet në dispozitën përkatëse në të cilën parashikohet figura konkrete. Në Kodin Penal ka dispozita në të cilat parashikohen vepra penale, të cilat kryhen vetëm më veprim, ashtu sikur ka dispozita në të cilat parashikohen vepra penale, të cilat mund të kryhen vetëm më mosveprim<sup>236</sup>. Por, në pjesën më të madhe të dispozitave të pjesës së posaçme të Kodit Penal, parashikohen vepra penale që mund të kryhen si me veprim ashtu edhe me mosveprim.

## 2. KUNDËRLIGJSHMËRIA

Një veprim ose mosveprim si element përbërës i veprës penale që të jetë i kundërligjshëm duhet të vijë në kundërshtim me normat dhe rendin juridik, pra duhet të jetë në kundërshtim me ligjin. Kundërligjshmëria paraqet bazën juridike për përcaktimin e veprës penale. Në asnjë rast, veprimi ose mosveprimi, nuk mund të përbëjë veprë penale pa u parashikuar shprehimisht në ligj një gjë e tillë. Përkufizimi për kundërligjshmërinë e veprës rezulton nga përkufizimi që i bëhet veprës nga norma e caktuar. Vepra mund të jetë e kundërligjshme, por jo gjithmonë mund të përbëjë një veprë penale. Ajo mund të jetë shkelje administrative ose civile. Për shëmbull, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor mund të përbëjë kundërvajtje administrative nëse nuk ka sjellë pasojat e parashikuara me ligj. Ajo mund të përbëjë veprë penale dhe ka sjellë ndonjëherë prej pasojave, që parashikohen në Kodin Penal. Nocioni i kundërligjshmërisë është i përbashkët në të gjitha degët e së drejtës, në të drejtën civile dhe në të drejtën administrative. Dallimi ekziston tek pasojat që sjell kjo kundërligjshmëri tek vepra penale nga pasojat që sjell kundërligjshmëria tek degët e tjera të së drejtës. Dallim tjetër është përse i përket llojit të sanksioneve që

<sup>234</sup> I.Salihi., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme. Prishtinë, Tetor 2010, fq 180

<sup>235</sup> V.Kambovski., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme. Shkup 2010, fq 123

<sup>236</sup> V.Kambovski., E Drejta Penale, Pjesë e Pergjithshme, Shkup 2010, Fq.201

parashikohen për çdo rast konkret të kundërligjshmërisë. Që të jetë i kundërligjshëm veprimi ose mosveprimi, duhet të parashikohet nga norma juridike-penale. Kërkesa e kundërligjshmërisë, buron nga parimi i ligjshmërisë, i parashikuar në nenin 2 të Kodit Penal se “askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë që më parë nuk është parashikuar shprehimisht me ligj si krim ose kundërvajtje penale”. Parim ky i shprehur edhe me shprehjen : “*Nullum crimen sine lege*”, “*Nullum poena sine crimen*”. Kundërligjshmëria, sipas brendësisë së saj, është e natyrës objektive. Kjo përcaktohet duke vënë në relacion veprimin ose mosveprimin e individit me normat e së drejtës penale. Kësisoj, në të gjitha rastet kur sjellja e njeriut është në kundërshtim me normat e legjislacionit penal, të cilat urdhërojnë apo ndalojnë ndonjë veprim, mund të konstatojmë se sjellja e njeriut është e kundërligjshme. Mirëpo, kundërligjshmëria, edhe pse sipas natyrës së saj është komponent i natyrës objektive, në disa raste ajo përmban edhe elementë subjektive. Si shëmbull mund të merret neni 247 i Kodit Penal sipas të cilit “mbajtja pa të drejtë e uniformës, e një dokumenti apo e një shenje dalluese që tregojnë cilësinë e një punonjësi që kryen detyrë shtetërore apo një shërbim publik”. Në kuadër të këtij paragrafi kemi kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet, por nëse kjo mbajtje e uniformës është bërë me qëllim fitimi ose ka prekur liritë apo të drejtat e shtetasve përbën veprë penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet<sup>237</sup>. Nga ekzistenca ose jo e këtij elementi, varet dhe cilësimi ligjor i veprës penale. Si konkluzion mund të thuhet se veprimi ose mosveprimi është i kundërligjshëm, kur ai vjen në kundërshtim me ndonjë normë ndaluese apo urdhëruese të ligjit. Supozimi i mësipërm është plotësisht i arsyeshëm, sepse nëse një veprë nuk është e kundërligjshme, ajo nuk mund të konsiderohet veprë penale. Ndërsa, në disa figura të tjera kundërligjshmëria shprehet qartë. Përmëndja në mënyrë të shprehur i elementit të kundërligjshmërisë në disa figura të veprës penale, kursesi nuk do të thotë se veprat e tjera penale, të cilat nuk është shprehur kundërligjshmëria në figurën e tyre, nuk janë të kundërligjshme. Përkundrazi, kundërligjshmëria është element themelor dhe konstituti i të gjitha veprave penale. Por, në disa raste, për shkak praktikë, ky element përmendet në mënyrë të shprehur. Disa autorë të së drejtës penale bëjnë dallimin ndërmjet kundërligjshmërisë në aspektin formal dhe kundërligjshmërisë në aspektin material. Kundërligjshmëria në aspektin formal është kur veprimi ose mosveprimi paraqitet si shkelje e normës urdhëruese apo ndaluese, e cila me ligj përcaktohet si veprë penale. Kundërligjshmëria, në aspektin material, është veprimi, i cili vjen në kundërshtim me normën e caktuar penale juridike, por në të njëjtën kohë, edhe dëmton marrëdhënien shoqërore, e cila është e mbrojtur posaçërisht nga kjo normë. Ky kuptim material i kundërligjshmërisë nxjerrë në pah dhe rrezikshmërinë shoqërore, si element tjetër i përbashkët ndërmjet veprës penale dhe figurës së veprës penale.

### 3. RREZIKSHMËRIA SHOQËRORE

Rrezikshmëria është vlerësimi negativ që i bëhet një veprë (veprim ose mosveprim) në një shoqëri të caktuar dhe në një periudhë kohe të caktuar, nga ligjëvesni. Kriteri që ka patur parasysh ligjvënësi në vlerësimin e një veprë, është sjellja e njeriut që paraqet rrezik për shoqërinë dhe individin. Ky vlerësim ka karakter objektiv dhe jo subjektiv. Ai merrë për bazë marrëdhëniet shoqërore, të cilat çënohen nga kjo sjellje. Sa më të rëndësishme të jenë këto marrëdhënie shoqërore të mbrojtura posaçërisht nga ligji penal, aq më e rrezikshme është edhe vepra. Dhe sa më pak e rëndësishme të jetë kjo marrëdhënie shoqërore, aq më pak e rrezikshme është edhe vepra. Nuk mund të konsiderohet veprë penale ajo veprë e cila nuk është e rrezikshme për shoqërinë. Në Kodin Penal, rrezikshmëria shoqërore nuk përmendet në mënyrë të veçantë si element i figurës së veprës penale. Shpesh kjo nënkuptohet, si pjesë përbërëse e veprës penale. Pikërisht, çmimi negativ që i bën shoqëria veprave (veprimeve ose mosveprimeve), të cilat çënojnë vlera të rëndësishme shoqërore, të cilat përbëjnë objekt studimi të së Drejtës Penale, kjo degë e së drejtës e quan rrezikshmëri shoqërore. Meqënëse janë marrëdhëniet shoqërore-juridike që vendosen për mbrojtjen pikërisht të kësaj kategorie vlerash në një shoqëri të caktuar, në një periudhë kohore të dhënë, ato që përbëjnë thelbin e veprës penale, objektin e saj, e Drejta Penale rrezikshmërinë shoqërore e konsideron tiparin material të vetë veprës penale. Ky tipar përfaqëson një nga elementët në të cilën gjen shprehje ana e jashtme e veprës penale dhe figurës së saj. Pikërisht mungesa e rrezikshmërisë shoqërore e veprës ka shërbyer për ligjvënësin si bazë juridike për të moskonsideruar si vepra penale disa vepra, të cilat sjellin pasoja të dëmshme për interesat e individit, të shtetit, apo të shoqërisë. Të tilla janë rastet e pasojave që vijnë në rastet kur personi vepron në kushtet e mbrojtjes së nevojshme (parashikuar nga dispozita e nenit 19 të Kodit Penal), nevojës ekstreme (parashikuar nga dispozita e nenit 20 të Kodit Penal), ushtrimi i një të drejte apo përmbushja e detyrës (parashikuar nga dispozita e nenit 21 të Kodit Penal) dhe heqjes dorë nga kryerja e veprës penale (parashikuar nga dispozita e nenit 24 të Kodit Penal). Rrezikshmëria shoqërore ka karakter dinamik, është e ndryshme në varësi nga rrethanat, koha, vëndi si dhe nga ana

---

<sup>237</sup>V.Kambovski., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme, Shkup 2010, fq 201

subjektive e veprës penale. Mirpo, përkundër karakterit relativ dhe dianmik të nocionit të rrezikshmërisë shoqërore, ekzistojnë disa vlera të përgjithëshme që tani konsiderohen universale, siç është jeta, shëndeti, etj. Rrezikimi apo dëmtimi i tyre janë konsideruar, po konsiderohen dhe do të konsiderohen si vepra penale<sup>238</sup>. Fakti që rrezikshmëria shoqërore përbën tiparin material të veprës penale reflektohet sidomos nga ligjvënësi në hartimin dhe miratimin e Kodit Penal. Reflekon, së pari, në përcaktimin e rrethit të veprave, të cilat do të konsiderohen prej tij si vepra penale në periudha të ndryshme kohe. Së dyti, reflekton në ndarjen e veprave penale në krimë dhe kundërvajtje penale. Së treti, në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit për çdo figurë vepre penale konkrete që parashikohet në pjesën e posaçme të Kodit Penal. Në masë jo të vogël, rrezikshmëria shoqërore (shkalla e saj) ndikon edhe në rastet e përjashtimit të të miturit nga dënimi (parashikuar nga dispozita e nenit 52, e Kodit Penal); në rastet e uljes së dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji (parashikuar nga dispozita e nenit 53, e Kodit Penal), etj.

#### 4. FAJI

Në përkufizimin i cili u dha për veprën penale, përveç kundërligjshmërisë dhe rrezikshmërisë shoqërore, si element të përbashkët me figurën e veprës penale, është edhe faji. Realizimi i figurës së veprës penale, në mënyrë të kundërligjshme nuk është mjaftueshëm që ai veprim të trajtohet si vepër penale në kuptimin objektiv. Por, për të drejtën penale është i pranueshëm nocioni objektiv-subjektiv. Për të ekzistuar vepra penale nuk mjafton vetëm realizimi i figurës së veprës penale, është i nevojshëm edhe faji nga ana e autorit. Faji paraqet në vetvete qëndrimin psikik që mban personi kundrejt veprës shoqërisht të rrezikshme që vijnë apo mund të vijnë prej saj, të kundërligjshme dhe pasojës së dëmshme. Faji shprehet në formën e dashjes ose të pakujdesise. Një person do të konsiderohet se ka kryer vepër penale me faj në rastet kur ka ditur se me veprim ose mosveprimin e tij do të shkakëtojë pasojën e ndaluar në botën e jashtëme, pasojë që në ligj është e parashikuar si vepër penale. Për të konstatuar se personi ka ditur apo jo se po kryen një vepër penale duhet depërtuar në qëndrimin e tij psikik. Qëndrimi psikik është në radhë të parë një proces i caktuar i brendshëm të të menduarit, që zhvillohet në trurin e njeriut, në ndërgjegjen e tij. Ky proces zhvillohet nën ngacmimet e faktorëve të jashtëm, të cilët e rrethojnë personin. Janë faktorë që ndikojnë në formimin e personalitetit të tij. Kur flasim për personalitet, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe faktorët biologjikë apo të trashëgimisë që ndikojnë në të. Për këtë arsye, me të drejtë disa penalistë theksojnë në mënyrë figurative se faji është një lloj ure ndërmjet veprës dhe personalitetit të autorit, përkatësisht faji konsiderohet si portë në të cilën autori hyn në fushën e së drejtës penale. Personi për të vepruar me faj duhet të jetë edhe i përgjegjshëm, duhet të ketë zhvillim intelektual normal dhe të jetë në gjëndje të udhëheqë në mënyrë të vetëdijshme veprimet e tij<sup>239</sup>. Faji është element i domosdoshëm i figurës së veprës penale të përgjithëshme, sepse faji është një nga shtyllat kryesore mbi të cilën mbështetet sistemi i së drejtës penale. Vepër penale, faj, denim. Por, nëse nocioni i tillë i fajit largohet nga ky sistem, bëhet problematik dhe vetë nocioni i veprës penale, i cili në atë rast nuk do të duhej të koncentrohet në veprimin e njeriut dhe shkakëtimin e cënimit të marrëdhënieve shoqërore të mbrojtura nga ligji penal. Nuk ka vepër penale, nuk ka dënim pa faj (*nullum crimen, nulla poena, sine culpa*). Faji në çdo rast ka karakter individual dhe duhet të vërtetohet gjatë procesit penal. Kjo garanton paprekshmërinë e personit të pafajshëm, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe nuk lejon që asnjë person të pafajshëm të dënohet, e anasjelltas, asnjë person fajtor të mos mbetet pa u dënuar. Problem i fajit në të drejtën penale, lidhet ngushtë me parimin e ligjshmërisë dhe me parimin kushtetues të prezumimit të pafajësisë.

#### PERFUNDIM

Shumica e legjislacioneve moderne bashkohore, në të cilën bën pjesë edhe Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, kanë konsideruar si shkak kryesor të veprës penale, atë veprim apo mosveprim të drejtpërdrejtë, që sjell në mënyrë të domosdoshme ardhjen e pasojës (ose mundësinë e ardhjes së saj), të cilin e quan shkak i domosdoshëm (i drejtpërdrejtë, determinant). Në këtë mënyrë, duke përcaktuar atë që quhet shkak kryesor, e drejta penale, bën njëkohësisht edhe dallimin ndërmjet tij dhe shkaqeve të tjerë, të cilët edhe pse mund të kenë një farë lidhjeje me pasojën, nuk luajnë rol përsa i takon marrjes ose jo të një apo disa personave në përgjegjësi penale. Studimi i figurës së veprës penale, faji, kundërligjshmëria, rrezikshmëria shoqërore, identifikimi, rast pas rasti, i elementëve përbërës të saj, ndihmon juristin për të bërë dallimin e qartë ndërmjet veprave penale. Kësisoj, do të jemi në gjëndje të përcaktojmë saktë dispozitën (nenin) konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal, me të cilën do të cilësohet (kualifikohet) juridikisht vepra penale dhe, mbi bazën e së cilës, do të akuzohet autori i saj. Në këtë kuptim,

---

<sup>238</sup> I. Salihu., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme, Prishtinë 2010, fq 230

<sup>239</sup> Po aty



nënvizohet se, elementet e veprës penale në përgjithësi (figura e veprës penale) janë kushte paraprake për përgjegjësinë penale dhe fajsinë e subjektit që ka kryer veprën penale. Sa më i bazuar të jetë procesi i përcaktimit të figurës së veprës penale, aq më ligjore do të jetë veprimtaria e organeve të proçedimit penal dhe të drejtësisë penale në vazhdimin e veprimeve të mëtejshme. Kam konstatuar se ka një prirje në rritje të veprave penale të kryera me mosveprim, e kushtëzuar kjo nga vete zhvillimi shoqëror-ekonomik, varësia e funksionimit të institucioneve të ndryshme etj. Si rrjedhojë, do të rekomandoja me këtë rast parashikimin nga legjislacioni ynë (Kodi Penal), i një numri më të madh të figurave të veprave penale që mund të kryhen me mosveprim. Këto raste, shërbejnë ose si element cilësues të veprës penale, ose për të bërë dallimin ndërmjet figurave të ndryshme të veprave penale, brënda së njëjtes lloji veprës penale, (në shumë raste të tjera, elementë të tillë shërbejnë për gjykatën ose si rrethana lehtësuese ose si rrethana rënduese). Në këto kushte, pasurimi dhe përditësimi i planeve, programeve e teksteve mësimore universitare të fakulteteve të drejtësisë si dhe të Shkollës së Magjistraturës, përbëjnë detyrë të përherëshme të kohës.

#### REFERENCES

- [1] Elezi.I., *E drejta penale, Pjesa e posaçme*, Botime Erik, 2007.
- [2] Kambovski Vllado, *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, Furkan, 2010.
- [3] Romano-Grasso, *Commentario sistematico del codice penale*, 2004.
- [4] F. Mantovani, *Diritto Penale, parte generale*, Padova ,2007, fq.100
- [5] Rampioni, *Contributo alla teoria del reato permanente*, Padova 1988.
- [6] Muci, Sh., *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, Botime Ora 2006.